

VENDIM
Nr. 71/2025

**PËR NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR
PËR SHQYRTIMIN DHE PËRZGJEDHJEN E KANDIDATURAVE TË KOMISIONIT
RREGULLATOR TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës; të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Shqyrtimin dhe Përzgjedhjen e Kandidaturave të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me përfaqësim proporcional nga çdo grup parlamentar, si më poshtë:

- a) Nga grupi parlamentar i shumicës parlamentare caktohen deputetët:
 - i. Damian Gjiknuri kryetar (Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste),
 - ii. Aurora Mara anëtare (Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste),
 - iii. Ermal Pacaj anëtar (Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste);
- b) Nga grupet parlamentare të pakicës parlamentare caktohen deputetët:
 - i. Oerd Bylykbashi anëtar (Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike),
 - ii. Ivi Kaso anëtar (Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike).

2. Komisioni shqyrton kandidaturat për anëtarë të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, verifikon përmbushjen e kriterëve ligjore dhe përgatit raportin përfundimtar me propozimet përkatëse për Kuvendin.

3. Procedura e shqyrtimit dhe përzgjedhjes së kandidaturave kryhet sipas dispozitave të Rregullores së Kuvendit për zgjedhjen në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, përveçse kur përcaktohet ndryshe në nenin 17, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Komisioni i Posaçëm Parlamentar e përfundon veprimtarinë e tij brenda datës 28 tetor 2025. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar dhe vendim të Komisionit, Kuvendi vendos për zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së tij.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës, si dhe për mbështetjen me burime njerëzore, financiare dhe logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni të Posaçëm Parlamentar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 16.10.2025.